




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**PROGRAM ORIENTUES IMATURËS SHTETËRORE  
PËR ARSIMIN E ORIENTUAR  
(ARTISTIK)  
DEGA: KOREOGRAFI**


**LËNDA:  
“HISTORI BALETI”  
(PROVIM ME ZGJEDHJE)**


**VITI SHKOLLOR 2025– 2026**



## PËRMBAJTJA

1	HYRJE .....	3
2	PËRMBAJTJA E PROGRAMIT .....	5
3	STRUKTURA E TESTIT.....	6
4	TABELAT E REZULTATEVE TË TË NXËNIT PËR SECILËN TEMATIKË.....	11





## 1 HYRJE

Historia e baletit është një nga lëndët e kurrikulës artistike në arsimin e mesëm me drejtim të orientuar artistik, dega “Koreografi”, integron njojuritë, shkathësitë, qëndrimet dhe vlerat nëpërmjet lëndëve: *Histori baleti shqiptar*, *Folklor koreografik* dhe *Histori baleti botëror*. Ajo ndihmon në zhvillimin e njojurive artistike që u shërbejnë nxënësve në aspektin personal, social dhe artistik.

Mësimi i mjaft lëndëve teorike artistike në këtë degë, iu ofron nxënësve mundësi për të zhvilluar të kuptuarit e njojurive dhe të proceseve të zhvillimit të kërcimit në periudha të ndryshme të historisë së njerëzimit, të praktikave më të përdorura nga njeriu për zhvillimin e kërcimit, të kontributit të arteve në shoqëri dhe të zbatimeve të saj në jetën e përditshme.


Programi orientues për provimin me zgjedhje histori baleti, përfshin njojuritë, konceptet dhe aftësitë më të rëndësishme të zhvillimit të historisë së baletit për shkollën e mesme artistike të sistemit 3 – vjeçar.

Ky program orientues për vitin shkollor 2024-2025, përbën një dokument të vlefshëm për nxënësit e interesuar dhe specialistët e përfshirë në procesin e vlerësimit për provimin e Maturës Shtetërore.

Programi:


- Gjeneron informacionin e nevojshëm për mësuesit e historisë së baletit, që do të përgatisin maturantët për provimin histori së baleti, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Orienton nxënësit për materialet kyçë mësimore, *njojuritë, konceptet* dhe *aftësitë kryesore* që duhet të zotërojnë ata për të përballuar me sukses provimin histori baleti, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Përbën, gjithashtu, një *dokument zyrtar*, që duhet zbatuar me korrekësi nga specialistët e përfshirë në hartimin e fondit të pyetjeve dhe tezës së provimit të historisë së baletit, si lëndë me zgjedhje për Maturën Shtetërore.

Programi orientues për provimin me zgjedhje histori baleti, synon vlerësimin e njojurive, aftësive dhe qëndrimeve të nxënësve në këtë lëndë, duke u mbështetur në lëndët: *histori baleti shqiptar*, *folklor koreografik* dhe *histori baleti botëror*, si dhe duke mbajtur parasysh formimin e njojurive dhe rezultateve të të nxënëtit.



Programi duhet shqyrtuar me kujdes dhe rigorozitet nga secili prej grupeve të interesuara, ku një kujdes i veçantë duhet bërë nga specialistët e përfshirë në hartimin e fondit të pyetjeve dhe tezës së provimit të historisë së baletit, si lëndë me zgjedhje për Maturën Shtetërore. **Ata nuk duhet të përfshijnë për vlerësim çështje mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program.** Vëmendje të tregojnë këta specialistë edhe në lidhje me sigurimin e balancës midis përqindjes që zë secila temë studimi në këtë program, me përqindjet që zënë këto tema në testin e provimit.

Materiali burimor mbi të cilin duhet të punojnë nxënësit, janë leksionet që ata kanë marrë nga mësuesit e tyre apo të gjitha burimet që ata kanë përdorur gjatë viteve për shqyrtimin e përbajtjeve mësimore, të tillë si: leksione, tekste të përdorura që kanë të bëjnë me historinë e baletit shqiptar, historinë e baletit botëror (Histori e baletit botëror, K.V. Burian, Histori baleti Viviana Durante, Baleti në kulturën perëndimore Carol Lee, Histori e kërcimit , Gayle Kassing) dhe folklorit koreografik (Skënder Selimi).




## 2 PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi orientues për përgatitjen e provimit të lëndës së historisë së baletit me zgjedhje është mbështetur në:

- Programin e lëndës folklor koreografik, klasa e 10- të;
- Programin e lëndës histori baleti shqiptar, klasa e 10- të;
- Programin e lëndës histori baleti botëror klasa e 11– të dhe 12 - të.

Për të qenë lehtësish i përdorshëm, programi përmban *strukturën e testit* në të cilën jepen tematikat si dhe pesha e tyre. Programi përmban rubrikën *e rezultateve të të nxënshit* ku përcaktohen konceptet dhe aftësitë kryesore për çdo tematikë të lëndës së folklorit koreografik, histori baleti shqiptar dhe histori baleti botëror 10-12.




### 3 STRUKTURA E TESTIT


Një nga aspektet më të rëndësishme në zhvillimin e vetëdijes artistike janë lëndët formuese dhe teorike të degës koreografi. Këto njojuri e ndihmojnë nxënësin në jetën profesionale dhe artistike. Përmbushja e kompetencave artistike që një nxënës duhet të zotërojë në fund të shkollimit, arrihet nëpërmjet tematikave integrues të marra nga lëndët: *Folklor koreografik*, *Histori baleti shqiptar* dhe *Histori baleti botëror*. Për secilën tematikë është **paraqitur pesha që zë secila prej tyre kundrejt orëve totale** të lëndës në zhvillimin e njohurive dhe rezultateve të të nxënëtit që duhet të demonstrojë nxënësi në përmbushjen e kompetencave artistike. Tematikat dhe renditja e tyre nuk nënkuftojnë që përbajtja e testit duhet të zhvillohet në këtë renditje. Në përgatitjen për përmbushjen e këtij programi orientues do të përdoren programet e lëndës së folklorit koreografik, historisë së baletit shqiptar dhe historisë së baletit botëror për klasat 10-12.

Nr.	Tematikat	Pesha	Përbajtja sipas tematikave
1.	<b>FOLKLORI KOREOGRAFIK</b>	10%	<ul style="list-style-type: none"><li>• <b>Karakteristikat e përgjithshme të lirikës në koreografi</b><ul style="list-style-type: none"><li>○ Ndarja etno – koreografike</li><li>○ Tematikat specifike të fushave që përbajnjë gjininë lirike në koreografi</li><li>○ Karakteri i valles lirike shqiptare</li><li>○ Strukturat e ndërtimit arkitektonik të valles lirike shqiptare</li><li>○ Format e kërcimit popullor</li><li>○ Specifikat e shoqërimit muzikor në valle</li></ul></li><li>• <b>Epika në koreografi</b><ul style="list-style-type: none"><li>○ Karakteristikat e epikës në koreografi</li><li>○ Vallet e rënda</li><li>○ Vallet dyshe dhe treshe</li></ul></li></ul>


2.	<b>HISTORIA BALETIT SHQIPTAR</b>	20 %	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Baleti në gjysmën e parë të shekullit XX</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Grupet e para amatore koreografike dhe veprimitaria artistike</li> <li>○ Krijimi i Filarmonisë dhe veprimitaria artistike</li> </ul> </li> <li>• <b>Krijimi i Teatrit të Operas dhe Baletit</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Jeta dhe krijimtaria artistike e Skënder Selimit dhe baletet Sheherezade, Fadeta dhe Laurencia</li> <li>○ Jeta dhe krijimtaria e Panajot Kanaçit dhe baleti i parë Halili dhe Hajria</li> <li>○ Artistë dhe themeluesit e shkollës së baletit</li> <li>○ Jeta dhe veprimitaria e Agron Aliajt. baleti Cuca e maleve</li> <li>○ Krijimi i T.O.B dhe A.K.V.P</li> <li>○ Gëzim Kaceli dhe krijimtaria e tij si pjesë e fondit të artë të A.K.V.P.</li> <li>○ Veprimitaria artistike e Agron Aliaj mbas viteve '90</li> <li>○ Angelin Preljocaj.</li> <li>○ Baleti i Kosovës.</li> <li>○ Yjet e baletit shqiptar të njojur në skenat ndërkombëtare</li> </ul> </li> </ul>
3.	<b>HISTORIA BALETIT BOTËROR</b>	E 70 %	<p><b>Kërcimi në lashtësi dhe antikitet</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Burimet materiale, elementet dhe parimet themelore të kërcimit</li> <li>• Kërcimi në Egjiptin e lashtë dhe në Orientin e largët</li> <li>• Llojet e kërcimit në Greqinë dhe Romën</li> </ul>




		<p>Antike</p> <p><b>Mesjeta dhe llojet e kërcimeve;</b></p> <p><b>Rilindja</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Kërcimet e ulëta dhe të larta</li><li>• Llojet e kërcimeve</li><li>• Komedia e Artit.</li><li>• Artistët e Komedia e Artit</li><li>• Baleti i parë. Baltazar.</li></ul> <p><b>Shekulli XVII</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Mbreti Diellit.</li><li>• Epoka e Luli dhe Molier</li><li>• Krijimi i Akademisë mbretërore të kërcimit dhe lindja e koreografisë.</li><li>• Pierre Beauchamps, risitë e tij në balet.</li></ul> <p><b>Shekulli XVIII</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Familja Vestri</li><li>• Reformat e Hilverding në Vienë</li><li>• Maximilian dhe Pierre Gardel</li></ul> <p><b>Epoka e Noverit</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Reformat e Jean – Georges Noverre.</li><li>• Reforma e Gasparo Angiolini. .</li><li>• Evolimi i teknikës Akademike franceze. Reforma e dytë në baletin francez.</li><li>• Jean Dauberval. Baleti Kujdesi i kote</li></ul> <p><b>Baleti pre-romantik</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Karlo Blasis, teoricien i baletit pre –</li></ul>
--	--	--



		<p>romantik</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Koreodrama e Salvatore Vigano.</li></ul> <p><b>Baleti Romantik</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Koreografët, kompozitorët dhe balerinët e romantizmit</li><li>• Baletet romantike. Veçoritë e tyre.</li><li>• Analizëbaletet Silfide, Zhizel, Korsar, "Paquita", "Pas de Quatre."</li></ul> <p><b>Baleti europian në gjysmën e dytë të shekullit të XIX dhe Baleti rus në shekullin e XIX</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• CharlDidlo në formimin e teatrit të baletit rus.</li><li>• ArturSen – Leon dhe reformimi i baletit rus.</li><li>• MariusPetipa dhe teatri i baletit në gjysmën e dytë të shekullit të XIX. baletet e tij.</li><li>• Liqeni i Mjelmave, Rajmonda, Arrëthyesi, Bija e Faraonit, Bukuroshja e fjetur.</li></ul> <p><b>Ritmi dhe plasika e kërcimit në fillim të shekullit të XX. Sezonet Ruse</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Kërcimi i lirë. Pionerët Amerikanë të kërcimit të lirë:LoieFuller, RuthSt. Denis, Isadora Duncan</li><li>• Kërcimi ekspresionit gjerman: MaryWigman.</li><li>• Sezonet ruse dhe S. Djailjev. Koreografët</li></ul>
--	--	--



		<p>dhe artistët e sezoneve ruse</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Michael Fokin</li><li>• Ana Pavlova</li><li>• George Balanchine</li></ul> <p><b>Baleti në Europë, Amerikë dhe ish BRSS në shekullin e XX .</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Forma e reja të kërcimit akademik</li><li>• Agripina Vaganova dhe metoda Vaganova</li><li>• Vladimir Vasiliev, Ekaterina Maksimova</li><li>• Yuri Grigorovich</li><li>• Maya Pliseckaj, Natalia Makarova</li></ul> <p><b>Kërcimi modern shekulli XX</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Kërcimi modern në Amerikë: Martha Graham, Jose Limon, Doris Humphrey. Kërcimi xhaz dhe pionierët e tij në amerikë</li><li>• Avangardët e rinj amnerikanë: Ann Halprin, Merce Cunningham, Murray Louis</li></ul> <p><b>Kërcimi kontemporanë</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Dance teatër. Pina Bausch.</li><li>• Kërcimi i ri . Angli &amp; Francë</li><li>• Maria Rambert, Ninette de Valois, Frederic Ashton</li><li>• Margotte Fonteyn, Rudolf Nureyev</li><li>• Metodat e baletit</li><li>• Mikhail Barashnikov</li></ul>
--	--	---




#### 4 TABELAT E REZULTATEVE TË TË NXËNIT PËR SECILËN TEMATIKË

Për secilën tematikë, më poshtë paraqiten njohuritë dhe rezultatet e të nxënët që duhet të demonstrojë nxënësi për të përbushur dhe demonstruar njohuritë artistike në lëndën me zgjedhje histori baleti. Megjithëse njohuritë përcaktohen për secilën tematikë ato trajtohen të integruara dhe të lidhura me njëra - tjetrën.


##### TEMATIKA: Folklor koreografik

Njohuritë artistike	Rezultatet e të nxënët për realizimin e kompetencave artistike
<b>Karakteristikat e përgjithshme të lirikës në koreografi</b>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>argumenton ndarjen etno-koreografike;</li><li>gjykon mbi shtrirjen dhe karakteristikat e çdo treve;</li><li>përcakton temat kryesore të lirikës;</li><li>përcakton numrin e strukturave të kërcimit;</li><li>argumenton strukturën e trehapshit asimetrik dhe pesëhapshit asimetrik;</li><li>përcakton strukturën e dyhapshit të vazhdueshëm dhe trehapshit;</li><li>përcakton format e kërcimit popullor;</li><li>argumenton kërcimin në rreth të mbyllur, formën zinxhir, formën spiral dhe kërcimin solistik;</li><li>përcakton llojet e shoqërimit muzikor të valles popullore;</li></ul>
<b>Epika në koreografi</b>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>analizon <i>epikën</i> në vallet shqiptare;</li><li>përcakton <i>rëndësinë</i> dhe <i>përbajtjen</i> e <i>epikës</i> në koreografi;</li><li>analizon <i>vallet e rënda, vallet dyshe</i> dhe <i>treshe</i> karakterin dhe rëndësinë e tyre.</li></ul>

##### TEMATIKA: Histori e baletit shqiptar




Njohuritë artistike	Rezultatet e të nxënësit për realizimin e kompetencave artistike
<b>Baleti në gjysmën e parë të shekullit XX</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• njihet me grupet e para të baletit mbas luftës;</li><li>• përshkruan kërcimet e para koreografike dhe aktivitetet në të cilat morën pjesë këto grupe kërcimi;</li><li>• njihet me krijimin dhe rëndësinë historike të krijimit të filarmonisë.</li><li>• argumenton mbi aktivitetet artistike të Filarmonisë;</li><li>• analizon “Vëllazërimi i popujve”, spektakli i parë koreografik në Shqipëri.</li></ul>
<b>Krijimi i Teatrit të Operas dhe Baletit</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- njihet me krijimin e TOB dhe AKVP;</li><li>• Artistë dhe themeluesit e shkollës së baletit;</li><li>• argumenton mbi rëndësinë dhe rolin që luajtën në ngritjen profesionale të trupës së baletit dhe në hapjen e shkollës së baletit;</li><li>• përshkruan jetën dhe veprimtarinë artistike të koreografit Skënder Selimi “Fadeta”, “Laurencia” dhe “Shehrezade”;</li><li>• përshkruan jetën dhe veprimtarinë artistike të koreografit P.Kanaci dhe analizon baletin e parë shqiptar “Halili dhe Hajria”;</li><li>• përshkruan jetën dhe veprimtarinë artistike të koreografit Agron Aliaj dhe përcakton tematikën, autorët dhe personazhet e baletit “Cuca e Maleve”;</li><li>• analizon veprat e vëna në skenë nga koreografi Agron Aliaj mbas viteve '90;</li></ul>




## TEMATIKA: Histori e baletit botëror

Njohuritë artistike	Rezultatet e të nxënësit për realizimin e kompetencave artistike
<b>Kërcimi në lashtësi dhe antikitet</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• përcakton burimet materiale;</li><li>• përcakton elementet themelore të kërcimit;</li><li>• argumenton mbi përhapjen e kërcimit në lashtësi;</li><li>• evidenton karakteristikat e kërcimit në Egjpt dhe në Lindjen e largët;</li><li>• përcakton llojet e kërcimit në Greqi</li><li>• përcakton llojet e kërcimeve në Romën antike.</li></ul>
<b>Mesjeta dhe llojet e kërcimeve Rilindja</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• përcakton kërcimet popullore të periudhës</li><li>• shpjegon zhvillimin e kërcimit në periudhën e Rilindjes;</li><li>• shpjegon karakteristikat e kërcimeve të ulëta, të larta;</li></ul>
<b>Kërcimi në shekullin XVII</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• përcakton rëndësinë që mori kërcimi në periudhën e mbretit Luigji XIV;</li><li>• evidenton koreografët me të cilët bashkëpunoi mbreti;</li><li>• përcakton qëllimet e hapjes së Akademisë Mbretërore të kërcimit;</li><li>• argumenton studimet me të cilat u mor dhe zhvilloi Akademia;</li><li>• përcakton rëndësinë e hapjes së Akademisë;</li><li>• Shpjegon tiparet e spektaklevë të Luli dhe Molier.</li><li>• Pierre Beauchamps risitë e tij në balet</li></ul>

<b>Kërcimi në shekullin XVIII</b>	<p><b>Nxënësi::;</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përcakton rëndësinë e baleteve të Hilverding dhe analizon tri tipologjitet e baleteve;</li> <li>• përcakton reformat e Noverre;</li> <li>• argumenton rëndësinë e baletit si gjini teatrale;</li> <li>• analizon filozofinë e balet d'action të Noverre;</li> <li>• përcakton reformat e Gasparo Angiolini;</li> <li>• analizon veprimtarinë artistike të Jean Dauberval;</li> <li>• shpjegon baletet e Jean Dauberval;</li> </ul>
<b>Baleti pre-romantik</b>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• analizon teoritë e Karlo Blasis;</li> <li>• pëershkruan veprimtarinë e Salvatore Vigano dhe risitë e tij në artin e baletit;</li> <li>• shpjegon çfarë është koreodrama</li> </ul>
<b>Baleti Romantik</b>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• shpjegon stilin e kërcimit të kësaj periudhe;</li> <li>• pëershkruan leksikun e përdorur dhe aftësitë plastike të kërcimtarëve të kësaj periudhe;</li> <li>• shpjegon rëndësinë e kërcimit në majë të gishtave (puante);</li> <li>• pëershkruan strukturën e baleteve të romantizmit;</li> <li>• njeh koreografët dhe balerinët më të rëndësishëm të periudhës;</li> <li>• shpjegon baletet më të njoitura të romantizmit dhe kompozitorët e tyre ( zhizel, silfidë, korsar, paquita, pas de quatre ).</li> </ul>
<b>Baleti europian në gjysmën e dytë të shekullit të XIX dhe Baleti rus në shekullin e XIX</b>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• shpjegon veprimtarinë e Charles Didlo dhe rëndësinë e tij për formimin e teatrit të baletit Rus;</li> <li>• shpjegon veprimtarinë e Arthur Sen – Leon dhe rëndësinë e</li> </ul>



	<p>tij për reformimin e teatrit të baletit Rus;</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• analizon baletet kryesore të këtij koreografi në këtë periudhë;</li><li>• pëershkruan veprimtarinë e Marius Petipa dhe zhvillimin që mori baleti rus gjatë periudhës artistike të tij;</li><li>• snalizon baletet kryesore të Marius Petipa (e bija e faraonit, Rajmonda dhe baletet simfonike)</li><li>• analizon baletet simfonike kryesore (Arrëthyesi, Bukuroshja e fjetur, Liqeni I Mjelmave ).</li></ul>
<b>Ritmi dhe plasika e kërcimit në fillim të shekullit të XX</b>  <b>Sezonet Ruse</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• shpjegon çfarë forme estetike ka kërcimi i lirë dhe kush janë pionerët e këtij kërcimi;</li><li>• analizon veprimtarinë e amerikanëve Loie Fuller, Ruth St. Denis, Isadora Duncan;</li><li>• pëershkruan veprimtarinë e kërcimit të lirë europian;</li><li>• analizon veprimtarinë e Mary Wigman</li><li>• shpjegon rëndësinë e sezoneve ruse në baletin botëror;</li><li>• pëershkruan veprimtarinë e koreografëve, kërcimtarëve më të njohur të sezoneve ruse. Michael Fokin, Ana Pavlova, George Balanchine, Sergei Lifar, Vaslav Nijinsky;</li><li>• analizon baletet më të suksesshëm të sezoneve ruse;</li><li>• shpjegon ndryshimet që pësoi arti koreografik dhe teknika e tij në sezonet ruse.</li></ul>
<b>Baleti në Europë, Amerikë dhe ish BRSS në shekullin e XX</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• shpjegon format e reja të kërcimit akademik në Europë, Amerikë dhe BRSS;</li><li>• shpjegon zhvillimin e baletit europian dhe atij amerikan në shekullin XX;</li><li>• analizon koreografët më të rëndësishëm të kësaj periudhe;</li></ul>



	<ul style="list-style-type: none"><li>shpjegon format e baletit sovjetik dhe mënyrën e ndërtimit të tyre;</li><li>pëershkruan veprimtarinë e koreografëve më të njojur të baletit sovjetik dhe baletet e tyre;</li><li>Agripina Vaganova dhe metoda Vaganova.</li></ul>
<b>Kërcimi modern shekulli XX</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>shpjegon rrethanat e krijimit të baletit modern në botë dhe nënndarjet e tij;</li><li>tregon zhvillimin e kërcimit modern dhe format e tij;</li><li>pëershkruan veprimtarinë dhe veprat kryesore të Martha Graham, Jose Limón, Doris Humphrey;</li><li>shpjegon kërcimin xhaz dhe veprimtarinë e pionerëve të këtij kërcimi;</li><li>pëershkruan veprimtarinë dhe veprat kryesore të avangardëve të rinj amerikanë Ann Halprin, Merce Cunningham, Murray Louis.</li></ul>
<b>Kërcimi kontemporan</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>pëershkruan veprimtarin e Pina Bausch dhe veprat e saj kryesore;</li><li>analizon kërcimin e ri në Angli dhe Francë.</li><li>Maria Rambert, Ninette de Valois, Frederic Ashton</li><li>Margotte Fonteyn, Rudolf Nureyev, Mikhail Barashnikov</li><li>Metodat e baletit</li></ul>